



Raport Vlerësues i Zyrës së Këshilltarit të Përputhshmërisë Ombudsman (CAO)
Ankesë në lidhje me projektin e Hidrove në Shqipëri (Projekt i Korporatës
Financiare Ndërkombëtare IFC #583387)

Tiranë, Shqipëri

Prill, 2013

Zyra e Këshilltarit të Përputhshmërisë/Avokati i Popullit/Ombudsman
Korporata Financiare Ndërkombëtare/
Agjencia e Garantimit të Investimeve Shumëpalëshe
www.cao-ombudsman.org

Rreth CAO

Zyra e Këshilltarit të Përputhshmërisë (ZKP) *Ombudsman** (CAO), është mekanizmi i pavarur i përgjegjës për Korporatën Financiare Ndërkombëtare (IFC) dhe Agjencisë së Investimeve të Garantuara Shumëpalëshe (MIGA), degë e sektorit privat të Grupit të Bankës Botërore. ZKP/CAO, raporton direkt te Presidenti i Grupit të Bankës Botërore dhe mandati i saj, është të ndihmojë në adresimin e ankesave nga njerëzit e ndikuar nga projektet e mbështetura të IFC/MIGA, në një mënyrë që është e drejtë objektive e konstruktive dhe të përmirësojë rezultatet shoqërore dhe mjedisore të këtyre projekteve.

Për më shumë informacione, shikoni www.cao-ombudsman.org.

* Përkthimi "Përputhshmëri" është konsideruar më i përshtatshëm për fjalën "Compliance", bazuar në rolin e auditimit ose të inspektimit të CAO të politikave, standarteve, udhëzimeve, procedurave e të tjera.

** Ombudsman megjithëse përkthehet në Shqip Avokat i Popullit, në këtë përkthim nuk është ndryshuar nga anglishtja që të mos shkaktojë konfuzion, sepse i referohet rolit të Ombudsman të një Institucioni Financiar Ndërkombëtar dhe jo Avokatit të Popullit të emëruar nga Parlamenti Shqiptar.

Pasqyra e Lëndës

Pasqyra e Lëndës	3
LISTA E SHKURTIMEVE	4
1. 5	
1. Përmbledhje	5
2. Konteksti	5
2.1. Projekti	5
2.2. Ankesa	5
3. Vlerësimi	6
3.1 Metodologjia	6
3.2 Përmbledhje e çështjeve	6
4. Hapat e Mëtejshëm	7
Shtojca A. Procesi i zgjidhjes së ankesave të CAO	9

LISTA E SHKURTIMEVE

CAO	Zyra e Këshilltarit të Përputhshmërisë Ombudsman
EDEN	Qendra Mjedisore për Zhvillim, Edukim dhe Rrjetëzim
GoA	Qeveria e Shqipërisë
HPP	Hidrocentrali
IFC	Korporata Finaciare Ndërkombëtare
KESH	Korporata Elektroenergjetike Shqiptare
METE	Ministria e Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjetikës
MIGA	Agjencia e Investimeve të Garantuara Shumëpalëshe

1.

1. Përmbledhje

Një ankesë iu paraqit CAO në Janar 2013, nga Qendra Mjedisore për Zhvillim, Edukim dhe Rrjetëzim (EDEN) ("Ankuesi"). Ankuesi ngriti shqetësimet rreth efekteve negative të mundshme nga privatizimi i katër Hidrocentraleve në Shqipëri, ankuesi pohonte që një efekt i cili do të ndihej nga popullata Shqiptare në përgjithësi. CAO përcaktoi që ankesa përmbushte tri kriteret e përshtatshmërisë dhe kështu e filloi vlerësimin e ankesës. Tani kur ka finalizuar vlerësimin, CAO, konfirmon që ankuesi dëshiron të fillojë funksionin e përputhshmërisë së CAO në adresimin e ankesës. Vendimi u mor me kuptimin e qartë të dy zgjidhjeve në dispozicion dhe duke pasur parasysh klimën politike aktuale në Shqipëri. Ky raport vlerësues ofron një përmbledhje të procesit të vlerësimit përfshirë një përshkrim të projektit, ankesës, metodologjisë së vlerësimit dhe hapat e mëtejshëm.

2. Konteksti

2.1. Projekti¹

Sipas dokumentacionit të projektit të IFC, duke ndjekur vitet e investimeve të pamjaftueshme në sektorin e energjetikës, Shqipëria u bë shumë e varur në investimet private dhe financimin shumëpalësh për rehabilitimin dhe zgjerimin e infrastrukturës së energjisë elektrike. Si rrjedhojë, hidrocentralet e vendit në lumin Mat dhe lumin e Bisticës, ishin rehabilituar pjesërisht duke marrë fonde hua nga institucionet financiare shumëpalëshe. Duke bërë strategjinë për të pasur në dispozicion më shumë kapital për investime të tjera prioritare, Qeveria Shqiptare vendosi të privatizonte një portofol të hidrocentraleve - 1) Hidrocentrali i Ulzës dhe Hidrocentrali i Shkopetit në lumin Mat; 2) Hidrocentrali Bisticës I dhe Bisticës II, në lumin e Bisticës (4 Hidrocentralet). Kështu që Qeveria Shqiptare parashikon zhvillime të mëtejshme tashmë të filluara strategjia e reformës së sektorit të energjisë, duke tërhequr investime shtesë të huaja në sektorin e energjetikës në Shqipëri dhe specifikisht në projektet e prodhimit të hidroenergjisë. Para se të privatizonte hidrocentralet, reforma e sektorit të energetikës së vendit, filloi me ndarjen dhe privatizimin e aktiviteteve të shpërndarjes së energjisë elektrike të shërbimeve kombëtare të energjisë elektrike Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH).

Qeveria Shqiptare angazhoi IFC si Këshilltar Udhëheqës të ndihmojë në prezantimin e pjesëmarrjes së sektorit privat në hidrocentralet e energjisë elektrike të Shkopetit, Ulzës, Bistrica I dhe Bistrica II. Roli i IFC përfshinte të ndihmonte Qeverinë Shqiptare në strukturimin e projektit, përgatitjen dhe mbajtjen e një procesi përzgjedhës të drejtë, transparent dhe konkurrues të arrinte në shitjen e objekteve të një partner privat i përshtatshëm dhe i aftë të rehabilitonte në mënyrë eficiente dhe të operonte dhe mirëmbante impjantet dhe gjithashtu të ndihmonte Qeverinë Shqiptare të rriste në maksimum të ardhurat nga procesi i privatizimit.

2.2. Ankesa

¹ Të Dhëna mbi Projektin Shqyrtimi Fillestar të IFC dhe Shërbimet Këshillimore Hyrja Operative dhe Memorandumi i Diligjencës Ligjore:

<http://www.mete.gov.al/upload/Due%20Diligence%20Memorandum%20HEC%20Ulez%20Shkopet%20SHA.pdf> (Hyrë më 11 Mars 2013).

Në Janar 2013, ankuesi paraqiti një ankesë në CAO që ngrinte shqetësime specifike rreth efekteve të përceptuara si rezultat i privatizimit të katër hidrocentraleve aktuale. Ankuesi pohonte që privatizimi mund të çojë në reduktimin e energjisë elektrike nga shpërbërja direkte e KESH-it, i cili si pasojë mund të detyrojë korporatën e energjisë elektrike të blejë energji në tregun botëror dhe/ose nga pronari i ri i Hidrocentraleve për të përmbushur nevojat e konsumatorëve. Për pasojë ankuesi beson që kjo do të shkaktojë mungesa të vazhdueshme të energjisë elektrike dhe ndërprerje të energjisë elektrike në vend. Ata gjithashtu shprehen shqetësime që kur KESH-i të blejë energji shtesë do të çojë në mënyrë të pashmangshme ngritjen e tarifave të energjisë elektrike tek konsumatorët. Çështje të tjera të cituara përfshinin efekte të mundshme negative mjedisore nga veprimet e zotërimit në pronësi të Kürüm (Kürüm), kompania private e çelikut, e cila besohet të ketë fituar ofertën e blerjes së Hidrocentraleve. Në lidhje specifike me IFC, ankuesi besonte që në dhënien e Këshillës së Qeverisë Shqiptare, IFC shkeli Artikujt e Marrëveshjes së saj dhe Standardeve të Performancës së IFC.

Një përmbledhje më e detajuar e çështjeve, është prezantuar në seksionin 3.

3. Vlerësimi

3.1 Metodologjia

Qëllimi i këtij vlerësimi të CAO, është të sqarojë çështjet dhe shqetësimet e ngritura nga ankuesi, të mbledhë informacion se si palët e tjera të interesuara e shikojnë situatën dhe të ndihmojë ankuesin dhe Qeverinë Shqiptare të përcaktojë se cili funksion i CAO duhet të fillojë; Zgjidhja e Mosmarrëvesjes ose Përputhshmëria. CAO, nuk mbledh informacion të bëjë një gjykim në meritat e ankesës gjatë vlerësimit të saj.

Vlerësimi i CAO i ankesës përbëhej nga:

- Rishikimi i dokumenteve të projektit;
- Takimi me ekipin e projektit të IFC;
- Kryerja e takimeve konfidenciale dypalëshe me ankuesin, palët e tjera të interesuara (përfshirë ekspertë të energjisë, aktivistë mjedisorë dhe përfaqësues të sindikatës) dhe përfaqësues të Qeverisë Shqiptare (Zëvendës Ministërat e Ekonomisë, të Tregëtisë dhe të Energjetikës; dhe
- Një vizitë në terren në Tiranë në Mars të 2013.

Ky raport vlerësues konsolidon informacionin e marrë nga CAO dhe jep përcaktimin e bërë nga ankuesi lidhur me fillimin e Përputhshmërisë së CAO.

3.2 Përmbledhje e çështjeve

Bazuar mbi ankesën origjinale dhe angazhimet e mëtejshme të palëve të interesuara para dhe gjatë vizitës në terren të CAO, tabela në vazhdim përmbledh çështjet kryesore të ngritura nga ankuesi:

Çështja Kryesore	Përmbledhje
Diligjenca ligjore e IFC dhe mandati i saj.	<ul style="list-style-type: none"> • IFC nuk iu përmbajt politikave të veta në dhënien e Këshillës Qeverisë Shqiptare mbi përparësitë dhe të metat e privatizimit të Hidrocentraleve. • Qeveria Shqiptare duhet të eksplorojë burime të tjera të energjisë

	<p>përveç hidroenergjisë.</p> <ul style="list-style-type: none"> • IFC veprimi jashtë mandatit të saj duke i ofruar shërbime një ndërmarrjeje publike dhe ndërhyri tërthorazi në çështjet politike Shqiptare.
Procesi	<ul style="list-style-type: none"> • Njerëzve nuk iu dha një mundësi të ngrinin shqetësimet rreth privatizimit të Hidrocentraleve pasi publiku nuk u konsultua përpara dhe gjatë procesit të privatizimit. • Mungesë qasjeje në dokumentacionin e projektit.
Kompensimi i tokës	<ul style="list-style-type: none"> • Pronarët e tokave mbi të cilat ndodhen Hidrocentralet, nuk u kompensuan nga Qeveria e mëparshme komuniste. Një pyetje ishte ngritur nëse Qeveria Shqiptare do të adresojë këtë çështje tani. • Sipas ligjit Shqiptar, pronarët e tokave do të kompensohen duke pasur aksione në çdo kompani që e ka tokën e tyre në përdorim . Një pyetje ishte ngritur nëse KÛrÛm do t'i ofronte aksione të tilla pronarëve të tokave.
Të drejtat mbi ujën	<ul style="list-style-type: none"> • Uji është i rëndësishëm për vaditjen në zonat ku ndodhen Hidrocentralet. Sidoqoftë, me devijimin për përdorim nga KÛrÛm, komuniteti do të jetë i deprivuar nga të drejtat e tyre ndaj ujit.
Ndotja e mjedisit	<ul style="list-style-type: none"> • Me akses më të lehtë tek energjia elektrike, KÛrÛm si një prodhues çeliku do të rrisë prodhimin në këtë mënyrë do të shkaktojë më shumë ndotje në zonën e Elbasanit. • Shqetësimet rreth komuniteteve lokale që ndodhen afër Hidrocentraleve të ndikuara nga përmbytja.
Të tjera	<ul style="list-style-type: none"> • Punëtorët e tanishëm në impiant janë në rrezik të shkurtohen nga marrja nën kontroll nga KÛrÛm. • Efekti i mudshëm Kombëtar i rritjes së tarifave të energjisë elektrike nga që KESH do të jetë i detyruar të blejë energji elektrike nga operatorët e rinj ose tregjet botërore.

Në lidhje me këndvështrimin e Qeverisë Shqiptare, CAO takoi me dy Zëvendës Ministrat e Ekonomisë dhe të Tregëtisë dhe të Industrisë, të cilët ofruan një pasqyrë përmbledhëse të projektit të privatizimit dhe procesit të Diligjencës Ligjore i cili ishte ndjekur në zbatimin e projektit. Është bërë e ditur që sipas Ligjit Shqiptar dhe rekomandimeve të IFC, konsultimet publike ishin mbajtur të përfshinin publikun dhe shoqërinë civile. Për më tepër, IFC ka ndjekur të gjitha Standartet e Performancës të kërkuara në dhënien e këshillës së tyre dhe Qeveria Shqiptare, ka ndjekur në mënyrë rigorozë kërkesat ligjore për të filluar privatizimin e projektit. Proçesi i privatizimit ka qenë duke marrë efekt gjatë gjashtë - shtatë viteve të fundit dhe Qeveria Shqiptare, nuk kishte dëgjuar ndonjë ankesë rreth këtij procesi nga ankuesi. Gjithashtu, ata nuk janë në dijeni nëse EDEN mori pjesë në ndonjë proces konsultimi mbajtur nga Qeveria Shqiptare si pjesë e procesit të privatizimit. Sidoqoftë, të dy Zëvendës Ministrat shprehën gadishmërinë të takojnë me ankuesit të diskutojnë shqetësimet e tyre dhe të sqarojnë ndonjë specifikim të projektit dhe iu surgjeruan ankuesve t'iu drejtohen Qeverisë Shqiptare, formalisht në lidhje me këtë çështje.

4. Hapat e Mëtejshëm

Bazuar në ankesën origjinale dhe diskutimet e mëtejshme me palët e tjera të interesuara ndërmarrë gjatë vlerësimit, si edhe klimës politike aktuale në Shqipëri, ankuesit nuk besojnë që shqetësimet e tyre janë dëgjuar në një proces bashkëpunues për zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Për më tepër si shqetësimi i tyre kryesor është i lidhur me proçesin e dilgjençës ligjore të IFC, ankuesit informuan CAO që interesat e tyre, do të jenë shërbyer më mirë nga procesi i

Përputhshmërisë së CAO. Për këtë arsye ankesa do të transferohet te funksioni i Përputhshmërisë i CAO për vlerësim, sipas Udhëzimeve Operative të CAO.

Shtojca A. Procesi i zgjidhjes së ankesave të CAO

Zyra e Këshilltarit të Përputhshmërisë Ombudsman (CAO), është mekanizëm i pavarur burimi për Korporatën Financiare Ndërkombëtare (IFC) dhe Agjencinë e Investimeve të Garantuara Shumëpalëshe (MIGA) të Grupit të Bankës Botërore. CAO raporton direkt te Presidenti i Grupit të Bankës Botërore, dhe mandati i saj është të ndihmojë në adresimin e ankesave nga njerëzit e ndikuar nga projektet e mbështetura të IFC/MIGA, në një mënyrë që është e drejtë, objektive, dhe konstruktive dhe të përmirësojë rezultatet shoqërore dhe mjedisore të këtyre projekteve.

Vlerësimi fillestar është kryer nga funksioni i Zgjidhjes së Mosmarrëveshjes së CAO. Qëllimi i vlerësimit të CAO, është të: (1) sqarojë çështjet dhe shqetësimet e ngritura nga ankuesi/t); (2) të grumbullojë informacion se si palët e tjera të interesuara e shikojnë situatën; dhe (3) të ndihmojë palët e tjera të interesuara të kuptojnë opsionet e mbështetjes në dispozicion të tyre dhe të përcaktojë nëse ata do të preferojnë të ndërmarrin një zgjidhje bashkëpunuese nëpërmjet funksionit të Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të CAO, ose nëse çështja duhet të rishikohet nga funksioni i Përputhshmërisë së CAO.

Ky dokument është një dokument i të dhënave paraprake i pikëpamjeve të dëgjua nga ekipi i CAO, dhe shpjegimet e hapave të mëtejshëm të varura nëse palët zgjedhin të ndërmarrin procesin e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjes ose preferojnë procesin e Përputhshmërisë së CAO. *Ky raport nuk bën ndonjë gjykim mbi meritat e ankesës.*

Sipas Udhëzimeve Operative të CAO,² hapat në vazhdim janë ndjekur në mënyrë tipike në përgjigje të një ankese të marrë:

Faza 1: **Pranimi dhe njohja** e marrjes së ankesës

Faza 2: **Vlerësimi nëse ankesa përmbushë kriteret për shqyrtim:** Përcaktimi që ankesa përmbush kriteret për vlerësim nën mandatin e CAO (jo më shumë se 15 ditë pune).

Faza 3: **Vlerësimi i CAO:** "Vlerësimi i çështjeve dhe t'iu ofrojë mbështetje palëve të interesuara në kuptimin dhe përcaktimin nëse ata preferojnë të ndërmarrin një zgjidhje me konsensus nëpërmjet procesit të bashkëpunimit të thirrur nga funksioni i Zgjidhjes së Mosmarrëveshjes së CAO, ose nëse çështja duhet të trajtohet nga funksioni i Përputhshmërisë së CAO të rishikojë dilijencën ligjore të mjedisit dhe shoqërisë së IFC/MIGA. Koha për vlerësimin mund të zgjasë deri në 120 ditë pune në maksimum."

Faza 4: **Ndërmjetësimi i Zgjidhjes:** Nëse palët vendosin të ndërmarrin një proces bashkëpunues, fillon funksioni i Zgjidhjes së Mosmarrëveshjes i CAO. Procesi i Zgjidhjes së Mosmarrëveshjes bazohet zakonisht ose fillon me një Memorandum Mirëkuptimi dhe/ose një rënie dakord mbi rregullat themelore midis palëve. Memorandumi i Mirëkuptimit mund të përfshijë lehtësimin/ ndërmjetësimin, gjetjen e fakteve të përbashkëta, ose mënyra të tjera zgjidhjeje pajtimi që çojnë në një marrëveshje zgjidhjeje ose qëllimi të përshtatshëm, ose qëllime të tjera të përbashkëta të përshtatshme. Qëllimi kryesor i këtyre lloj mënyrave të zgjidhjes së problemeve do të jetë të adresojë çështjet e ngritura në ankesë, dhe çështjeve të tjera të rëndësishme

² Për më shumë detaje informacioni mbi rolin dhe punën e CAO, ju lutemi referohuni Udhëzimeve Operative të plota: http://www.cao-ombudsman.org/documents/CAOOperationalGuidelines_2013.pdf

relevante me ankesën që ishin identifikuar gjatë vlerësimit ose procesit të zgjidhjes së mosmarrëveshjes, në një mënyrë që është e pranueshme për palët e ndikuara³.

Ose

Vlerësimi i Përputhshmërisë /hetimi: Nëse palët zgjedhin për një proces Përputhshmërie, funksioni i Përputhshmërisë i CAO, do të fillojë një vlerësim të dilijencës ligjore të mjedisit dhe shoqërisë së projektit në pyetje të IFC/MIGA e të vendos nëse një hetim Përputhshmërie i IFC/MIGA, lidhur me performancën e projektit është merituar. Koha e Vlerësimit mund të zgjasë deri në 45 ditë pune në maksimum. Nëse një hetim është merituar, Përputhshmëria e CAO, do të ndërmarrë një hetim në thellësi të performancës së IFC/MIGA. Një raport hetimi me ndonjë mospërputhje të identifikuar, do të bëhet publik së bashku me përgjigjen e IFC/MIGA.

Faza 5: **Monitorimi** dhe ndjekja

Faza 6: **Konkluzionet/Mbyllja** e çështjes

³ Ku palët e interesuara nuk janë në gjendje të zgjidhin çështjet nëpërmjet procesit të bashkëpunimit brenda afatit kohor, Zgjidhja e Mosmarrëveshjes e CAO, fillimisht do të kërkojë të ndihmojë palët e interesuara nëpërmjet depërtimit në qorrsoakak(t). Nëse kjo nuk është e mundur, ekipi i Zgjidhjes së Mosmarrëveshjes, do të informojë palët e interesuara përfshirë edhe stafin e IFC/MIGA, Presidentin dhe Bordin e Grupit të Bankës Botërore dhe publikun që Zgjidhja e Mosmarrëveshjes së CAO, e ka mbyllur ankesën dhe e ka transferuar atë te Përputhshmëria e CAO për Vlerësim.